



REVISTAT ISLAME NË KONTEKSTIN SOCIALIST (JUGOSLLAVIA DHE SHQIPËRIA): NDIKIMI DHE SFIDAT (1945-1990)

*ISLAMIC JOURNALS IN THE SOCIALIST CONTEXT
(YUGOSLAVIA AND ALBANIA): INFLUENCE AND CHALLENGES
(1945-1990)*

Agon KRASNIQI

PhD Candidate, Bursa Uludağ University, Institute of Social Sciences, Kosovo

 <https://orcid.org/0009-0009-0752-250X>  <https://ror.org/03tg3eb07>

Abstrakt: Pas Luftës së Dytë Botërore, regjimet komuniste në Ballkan ushtruan një politikë shtetërore të sekularizmit të detyruar, e cila ndikoi drejtpërdrejt në shprehjen dhe transmetimin e mendimit islam. Megjithatë, brenda kufizimeve të vendosura nga shteti, disa revista islame si Edukata Islame, Islamska Misao, Glasnik, Preporod etj, arritën të mbijetojnë dhe të shërbejnë si platforma të rëndësishme për ruajtjen e identitetit fetar dhe intelektual të myslimanëve në rajon. Ky punim analizon rolin dhe ndikimin e revistave islame në Kosovë dhe Shqipëri gjatë periudhës 1945-1990, me fokus të veçantë te botimet si “Edukata Islame” (1971 e tutje) në Kosovë dhe përpjekjet e izoluara për botime islame në Shqipëri deri në ndalimin e fesë në vitin 1967. Në këtë kontekst, do të trajtohet mënyra se si këto revista funksionuan nën censurën shtetërore, çfarë tematikash trajtuan dhe cili ishte ndikimi i tyre në ruajtjen e diskursit islam në një periudhë represive. Gjithashtu, do të shqyrtohet dallimi midis qasjes së Jugosllavisë, e cila lejonte njëfarë lirie të kontrolluar për botimet fetare, dhe Shqipërisë, ku çdo shprehje fetare u ndalua plotësisht pas vitit 1967. Ky studim synon të kontribuojë në kuptimin e trajektores së mendimit islam në kontekstin socialist dhe të ndriçojë rolin e mediave islame si mjete të rezistencës kulturore dhe fetare.

Fjalë kyçe: mendimi islam, Edukata Islame, komunizmi, censura fetare

Abstract: Following the Second World War, communist regimes in the Balkans implemented a state-enforced policy of secularism, which directly impacted the expression and transmission of Islamic thought. Nevertheless, within the constraints imposed by the state, several Islamic journals (*Edukata Islame*, *Islamska Misao*, *Glasnik*, *Preporod* etc), managed to survive and served as important platforms for preserving the religious and intellectual identity of Muslims in the region. This paper analyzes the role and impact of Islamic journals in Kosovo and Albania during the period 1945–1990, with particular emphasis on publications such as *Edukata Islame* (from 1971 onward) in Kosovo and the isolated efforts to publish Islamic materials in Albania prior to the complete ban on religion in 1967. In this context, the study examines how these journals operated under state censorship, the themes they addressed, and their influence on maintaining Islamic discourse during a repressive period. Furthermore, it explores the contrast between Yugoslavia’s approach, which allowed a degree of controlled religious publishing, and Albania’s, where all religious expression was completely prohibited after 1967. This study aims to contribute to a deeper understanding of the trajectory of Islamic thought under socialist regimes and to highlight the role of Islamic media as instruments of cultural and religious resistance.

Keywords: Islamic thought, *Edukata Islame*, communism, religious censorship



Corresponding author: Agon Krasniqi, agonk122@gmail.com



Citation: Krasniqi, Agon. “Revistat islame në kontekstin socialist (Jugosllavia dhe Shqipëria): Ndikimi dhe sfidat (1945–1990).” In *Balkan Periodicals: The Trajectory of Islamic Thought in the Communist Period*, edited by Sevba Abdula, Ahmet Köroğlu, and Fatih Şabani, 13–28. Skopje: IDEFE Publications, 2025. <https://doi.org/10.51331/EB11AK>.

Hyrje

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Europa Lindore dhe Ballkani u përfshinë nga regjime socialiste që sollën me vete një qasje radikale ndaj fesë dhe institucioneve fetare.¹ Lufta e zhvilluar kundër nazizmit ndikoi në ngritjen e pushteteve komuniste në Ballkan, përfshirë këtu edhe Shqipërinë.² Nën ndikimin e ideologjisë marksiste-leniniste, feja u trajtua si një mbetje e së kaluarës që duhej tejkaluar përmes ndërtimit të “njeriut të ri socialist”. Si rezultat, në vendet si Jugosllavia dhe Shqipëria, u vendosën politika shtetërore të sekularizmit të detyruar, të cilat kufizuan rëndë shprehjen publike të fesë dhe veprimtarinë e institucioneve fetare.

Megjithatë, përkundër represionit shtetëror, në disa pjesë të Ballkanit u ruajt një hapësirë e kufizuar për shprehje fetare, e cila u manifestua edhe përmes botimeve periodike. Veçanërisht në Kosovë dhe në pjesë të tjera të ish-Jugosllavisë, disa revista islame si *Edukata Islame*, *Glasnik* apo *Islamska Misao* arritën të mbijetojnë brenda një kornize të rreptë të kontrollit ideologjik dhe vetëcensurës. Në anën tjetër, Shqipëria përjetoi një ndër periudhat më ekstreme të represionit fetar, duke ndaluar plotësisht çdo shprehje fetare pas vitit 1967 dhe duke shkatërruar çdo infrastrukturë të mendimit islam, përfshirë edhe revistat.³ Në këto rrethana të krijuara regjimi i Enver Hoxhës ndërmoi hapa ekstremë për të ndaluar çdo shprehje fetare, duke shpallur shtetin si “ateist” në vitin 1967 dhe duke ndaluar çdo lloj botimi me përmbajtje fetare.

Pavarësisht kufizimeve të rrepta të regjimeve socialiste në Kosovë dhe Shqipëri gjatë periudhës 1945–1990, revistat islame që arritën të botoheshin, veçanërisht në Kosovë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen e diskursit fetar, identitetit islam dhe transmetimit të dijeve tradicionale në forma të adaptuara ndaj kontrollit shtetëror. Krahasimi ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë do të vërtetojë se shkalla e lejimit institucional dhe qasja ideologjike e shtetit ndaj fesë përcaktoi drejtpërdrejt fatin dhe funksionin e mediave islame në secilin kontekst, gjë që ndikoi edhe në zhvillimet e mëtejshme si në aspektin politik po ashtu edhe në atë shoqëror.

Ky punim ka për qëllim të analizojë në mënyrë kritike rolin e revistave islame në ruajtjen e identitetit fetar dhe intelektual të myslimanëve në një kontekst represiv politik. Në qendër të analizës do të jetë revista “Edukata Islame” në Kosovë dhe përpjekjet e izoluara në Shqipëri për botime islame para ndalimit të fesë. Në mënyrë të veçantë, studimi do të fokusohet në:

1 Bernard Lory, *Europa Ballkanike nga 1945 në ditët tona* (Tiranë: Dituria, 2007), 67.

2 Shtjefan Xheçovi, et.al. (2008), *Historia e Popullit Shqiptar vëllimi IV* (Tiranë: Toena, 2008), 169.

3 Nichola Pano, *Feja në Shqipëri: Trashëgimia e epokës komuniste* (Tiranë, 2003), 146.

- Mënyrën se si këto revista funksionuan nën censurën shtetërore;
- Temat që trajtuan në përputhje me kufizimet ideologjike të kohës;
- Ndikimin e tyre në ruajtjen e diskursit islam;
- Krahasimin ndërmjet qasjes jugosllave dhe asaj shqiptare ndaj fesë dhe botimeve fetare.

Hipotezat e punimit kryesisht janë të lidhura me këto pika:

1. Si funksionuan revistat islame në një ambient politik të kontrolluar apo të ndaluar ndaj fesë në Kosovë dhe Shqipëri gjatë regjimeve socialiste?
2. Cilat ishin temat që trajtoheshin më shpesh në këto botime dhe si reflektonin ato realitetin politik të kohës?
3. Në çfarë mënyre ndikoi censura shtetërore dhe vetëcensura në përmbajtjen e këtyre revistave?
4. Pse në Kosovë u lejua një formë e kufizuar e mediave fetare, ndërsa në Shqipëri u zhdukën plotësisht?
5. A mund të konsiderohen këto revista si forma të rezistencës kulturore dhe ruajtjes së identitetit islam?

Duke ndjekur këtë qasje, punimi synon të kontribuojë në studimet mbi historinë e mendimit islam në Ballkan gjatë shekullit XX dhe të ndriçojë rolin e revistave islame si mjet rezistence ndaj shtypjes ideologjike.

Konteksti Historik dhe Politik i Periudhës 1945–1990 në Kosovë dhe Shqipëri

Periudha pas vitit 1945 përfaqëson një nga kapitujt më të rëndësishëm dhe më të vështirë për jetën fetare në Ballkan, veçanërisht për komunitetin mysliman në Kosovë dhe Shqipëri. Me vendosjen e regjimeve socialiste në të dy vendet, politika zyrtare shtetërore mori një drejtim të qartë sekularizues dhe shpesh antireligjioz, duke ndryshuar rrënjësisht raportin e institucioneve fetare me shtetin dhe shoqërinë. Në Jugosllavi, feja nuk u ndalua me ligj, por u vendos nën një kontroll të rreptë institucional. Në këtë ambient, komunitetet fetare u detyruan të përshtateshin me ideologjinë shtetërore. Megjithatë, krahas kufizimeve, ekzistonte një farë hapësire për veprimtari fetare të kontrolluar, përfshirë edhe botime periodike.⁴

⁴ George Gawrych, *Tolerating Islam in a Socialist State: Yugoslavia and the Yugoslav Muslims*. *East European Quarterly* (1983), 461.

Revista “Edukata Islame”, e themeluar në vitin 1971 nga Bashkësia Islame e Kosovës, luajti një rol të rëndësishëm në ruajtjen e diskursit islam ndër brezat e myslimanëve shqiptarë.⁵ Përmbajtja e saj përfshinte tema fetare, historike, morale dhe kulturore, por gjithmonë e filtruar në mënyrë që të mos binte ndesh me vijën politike të shtetit, kjo si rezultat i regjimit në kohën e Jugosllavisë, pasi që dalja nga vijat e kufizuara nënkuptonte ndërprerjen e publikimit të revistës. Autorët shpesh përdornin gjuhë të moderuar dhe shmangnin polemikat, duke demonstruar një formë të vetëcensurës intelektuale.

Një tjetër revistë me rëndësi ishte “Glasnik”, organ zyrtar i Bashkësisë Islame të Bosnjës, e cila shpesh kishte ndikim edhe në territoret tjera të ish-Jugosllavisë. Edhe pse shkruhej në gjuhën boshnjake, revista kishte përkthime dhe ndikim të ndjeshëm të myslimanët e Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut.⁶ Revistat si “Edukata Islame” dhe “Glasnik” shërbyen si ura komunikimi ndërmjet mendimit islam tradicional dhe sfidave të modernizmit socialist, duke ruajtur lidhjen e komuniteteve myslimane me trashëgiminë e tyre fetare e kulturore.

Revista “Islamska Misao” (Sarajevë, 1970–1989) u botua nga Bashkësia Islame e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe ishte një ndër platformat më të rëndësishme për mendimin islam modern në Jugosllavi. Revista përfshinte tema teologjike, filozofike dhe shoqërore, dhe shpesh trajtonte çështje të bashkëjetesës midis fesë dhe shtetit socialist.⁷ Një nga autorët më të njohur që shkruante rregullisht për këtë revistë ishte Husein Dozo, një dijetar boshnjak dhe teolog modernist, i cili përpiqej të harmonizonte parimet islame me parimet socialiste, duke promovuar një “Islam të përshtatur” për kohën dhe vendin. Kjo ishte një nga mënyrat e përpjekjes së mbijetesës së revistave islame të kohës, çka e bënte të mundur një sensibilizim kohor.

Në anën tjetër “Preporod”, e botuar në Sarajevë gjatë viteve 1970-1992, kishte karakter më kulturor e kombëtar, por shpesh përfshinte edhe tema fetare. Ajo i shërbente edukimit të gjeneratave të reja myslimane në kontekstin e një shoqërie zyrtarisht sekulare, por me praninë e dukshme të trashëgimisë islame. Poashtu kishte edhe revista lokale në Sanxhak dhe Maqedoni.⁸ Në qytete si Novi

5 *Edukata Islame: Revistë shkencore, kulturore islame tremujore* (Prishtinë, Bashkësia Islame e Kosovës), 6.

6 Hanidef Kajkuš, *Bosna Hersek'te Tefsir Çalışmaları ve Hüseyin Cozo Efendi Örneği* (Bursa: Bursa Uludag Üniversitesi, 2012), 54.

7 Hans Daiber, *Islamska misao u dijalogu kultura: Inoviranje i posredovanje između antike i srednjeg vijeka* (Sarajevo, 2007), 39.

8 Muhammed Huković, *Zaboravljena baština* (Zagreb, 1992), 27.

Pazar dhe Shkup u botuan revista më të vogla, me ndikim lokal, të cilat shpesh pasqyronin realitetin fetar të komuniteteve myslimane në këto zona. Shumica e tyre ishin botime të bashkësive islame lokale dhe ndihmonin në ruajtjen e identitetit religjioz dhe kulturor në këto komunitete.

Autorët dhe redaksitë duhej të ishin të kujdesshëm që të mos sfidonin vijën ideologjike të shtetit. Kritika ndaj socializmit, ateizmit shtetëror apo marksizmit ishte e ndaluar. Çdo botim duhej të kalonte nëpër filtrat e Bashkësisë Islame dhe shpesh edhe të organeve shtetërore, të cilat vlerësonin përputhshmërinë me normat e regjimit. Pjesa më e madhe e përmbajtjes nuk ishte teologjike në kuptimin klasik, por përqendrohej në moralin shoqëror, historinë islame, traditat kulturore dhe përkujtimin e figurave të respektuara fetare. Në anën tjetër kishte përpjekje për modernizim sidomos përmes revistës “Islamska Misao”, pati përpjekje për ta shfaqur Islamin si një fe që nuk bie ndesh me zhvillimin shoqëror, edukimin modern dhe punën kolektive, gjë që ndihmoi në legjitimimin e fesë në një sistem që e shihte atë me dyshim.⁹ Duhet të kuptohet se Revista Islamska Misao ishte revistë me karakter fetar botuar nga Rijaset Islamske Zajednice nga viti 1979 gjerë në vitin 1992, në Bosnjë dhe Hercegovinë, megjithatë kishte përpjekje për modernizim përmes të mos sulmuar sistemin, çka kjo shënonte edhe ndalimin e revistës.¹⁰

Vështrim i shkurtër për gjendjen e lirisë fetare në Kosovë në kuadër të Jugosllavisë Socialiste

Pas Luftës së Dytë Botërore, Kosova u përfshi në përbërjen e Federatës Socialiste të Republikave të Jugosllavisë (FSRY ose RFSJ), ku, ndonëse dominonte ideologjia socialiste, federata ruajti një qasje relativisht më të moderuar ndaj fesë krahasuar me Shqipërinë. Kushtetuta e vitit 1946 dhe pasueset e saj njohën në mënyrë formale lirinë e besimit, megjithëse në praktikë autoritetet komuniste ushtruan kontroll të fortë mbi institucionet fetare, përfshirë Bashkësinë Islame të Kosovës (BIK). Në këtë kontekst, Islami shihej nga udhëheqësit jugosllavë si një element potencialisht problematik për shkak të ndikimeve të jashtme (Turqia dhe Lindja e Mesme), por gjithashtu edhe si pjesë e trashëgimisë kulturore të popullsisë myslimane të vendit. Si rezultat, autoritetet jugosllave zbatonin një politikë të “tolerancës së kontrolluar”, që lejonte njëfarë hapësire për botime dhe aktivitete fetare, gjithmonë nën mbikëqyrje shtetërore dhe brenda kornizave të përcaktuara ideologjikisht.¹¹

9 Daiber, *Islamska misao*, 42.

10 Daiber, *Islamska misao*, 43.

11 Miranda Vickers, *Midis Serbëve dhe Shqiptarëve, një histori e Kosovës* (Tiranë: Dituria, 2004), 183.

Shqipëria dhe ndalimi total i fesë

Ndryshe nga Kosova, Shqipëria pas vitit 1945 ndoqi një linjë shumë më të ashpër. Me ardhjen në pushtet të Partisë së Punës së Shqipërisë (PPSH) me në krye Enver Hoxhën, filloi një proces i thellë i laicizimit të jetës publike dhe kontrollit absolut të institucioneve fetare, politikë kjo kryesisht e mendimit stalinist.¹² Në vitin 1967, Shqipëria u shpall zyrtarisht “shteti i parë ateist në botë”, duke ndaluar me ligj çdo aktivitet fetar, përfshirë botimet, predikimet, ritualet dhe mbajtjen e simboleve fetare.¹³

Ky akt përfaqësonte kulmin e një fushate më të gjerë shtetërore që e kishte parë fenë si pengesë për zhvillimin e shoqërisë socialiste dhe si një kërcënim për autoritetin absolut të partisë. Pas kësaj periudhe, të gjitha objektet e kultit u mbyllën, u shkatërruan ose u kthyen në ndërtesa publike, ndërsa udhëheqësit fetarë u burgosën, u përndoqën ose u detyruan të heshtnin.¹⁴

Për dallim nga Kosova dhe pjesët e tjera të Jugosllavisë ku revisitat islame mbijetuan përmes censurës dhe vetëpërmbytjes, në Shqipëri ndodhi:

- Zhdukja e tërë brezit të dijetarëve fetarë aktivë.
- Shtypja e çdo platforme për shprehje fetare, qoftë në formë reviste, ligjërimit publik apo shkollimi institucional.¹⁵

Kjo ndërpreu përfundimisht kontinuitetin e diskursit islam, dhe e bëri ringjalljen e tij pas vitit 1990 shumë të vështirë, duke kërkuar një rikonstrukcion nga e para të infrastrukturës dhe mendimit fetar.

Krahasimi i qasjeve ideologjike ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë dhe ndikimi mbi komunitetet myslimane

Jugosllavia përdori një strategji të kontrollit institucional të fesë për ta vënë atë në shërbim të socializmit vetëqeverisës, kurse Shqipëria zgjodhi eliminimin

12 Blendi Fevziu, *Enver Hoxha* (Tiranë: Uett Press, 2011), 193.

13 Pano, *Feja në Shqipëri*, 237.

14 Aleksander Dhima, *Modeli i propagandës; qasje antropologjike në realitetin mediatik* (Tiranë: Polisi, 2011), 30.

15 Azem Qazimi, *Procesi i asgjësimit të fesë në komunizëm* (Tiranë, 2012), 123.

total të saj nga jeta publike.¹⁶ Ky dallim kishte ndikime të thella për komunitetet myslimane në të dy vendet: në Kosovë, myslimanët kishin ende një hapësirë të kufizuar për të ushtruar dhe kultivuar besimin e tyre, ndonëse nën një formë të moderuar dhe të përpunuar, ndërsa në Shqipëri, identiteti fetar u detyrua të mbijetojë në fshehtësi dhe nën represionin e plotë shtetëror.¹⁷

Ky kontekst politik do të ndikojë drejtpërdrejt në mënyrën se si u zhvilluan dhe u trajtuan botimet islame në të dy vendet – temë të cilën do ta shqyrtojmë më tej në kapitujt në vijim.

Revista “Edukata Islame” në Kosovë: një platformë e mendimit islam në kuadër të Socializmit Jugosllav

Në një periudhë kur feja ishte subjekt i mbikëqyrjes dhe kontrollit të rreptë shtetëror, revista “Edukata Islame”, e cila filloi botimin në vitin 1971 nga Bashkësia Islame e Kosovës, përfaqëson një rast të rrallë të ekzistencës së një tribune islame në një shtet socialist. Ajo lindi si rezultat i një hapësire të kufizuar që regjimi jugosllav u ofronte institucioneve fetare, gjithnjë nën mbikëqyrje dhe brenda linjave ideologjike të përcaktuara nga partia.¹⁸

Themelimi dhe misioni i revistës

“Edukata Islame” u themelua në Prishtinë si organ periodik i Bashkësisë Islame të Kosovës, me synimin për të kultivuar vetëdijen fetare dhe për të ruajtur lidhjen e komunitetit mysliman me vlerat e besimit islam. Revista publikohej katër herë në vit dhe përfshinte artikujt në gjuhën shqipe, ndonjëherë edhe në boshnjakisht apo turqisht, që trajtonin tema të edukatës fetare, etikës islame, historisë islame dhe jetës së profetit Muhamed. Kjo shënonte edhe ruajtjen e vlerave fetare dhe kultivimit të saj në një periudhë mjaft të vështirë historike.¹⁹ Në mënyrë të kujdesshme dhe me një gjuhë të moderuar, autorët e shkrimeve në revistë synonin të ruanin autenticitetin e mësimave islame pa rënë ndesh me narrativën ideologjike të shtetit. Për shembull, theksi shpesh vihej mbi vlerat morale dhe edukative të Islamit, si ndershmëria, puna, respekti ndaj prindërve dhe ndihma për të varfrit – vlera që përputheshin pjesërisht me moralin socialist të promovuar nga regjimi.

16 Azem Qazimi, *Komunitetet fetare në Shqipërinë komuniste (dokumenta)* (Tiranë, 2014), 97.

17 Qazimi, *Komunitetet fetare*, 98.

18 Edukata Islame, *Edukata Islame: Revistë shkencore, kulturore islame tremujore*, 7.

19 Edukata Islame, *Edukata Islame: Revistë shkencore, kulturore islame tremujore*, 9.

Përmbajtja dhe tematika

Në përmbajtje, revista trajtonte:

- Komentime të ajeteve dhe haditheve në një gjuhë të thjeshtë dhe didaktike;
- Historikun e Islamit dhe figurat kyçe të civilizimit islam;
- Ese dhe reflektime mbi jetën e përditshme nga një këndvështrim islam;
- Raporte mbi aktivitetet e Bashkësisë Islame dhe organizimet lokale;
- Studime të thjeshtuara teologjike që mund të lexoheshin edhe nga publiku i gjerë.²⁰

Redaksia i kushtonte vëmendje të madhe ruajtjes së një toni të kujdesshëm dhe shmangies së çdo kritike të drejtpërdrejtë ndaj sistemit socialist apo autoriteteve shtetërore. Gjithashtu, revista nuk trajtonte çështje të ndjeshme politike, siç ishin të drejtat e myslimanëve si komunitet etno-fetar apo marrëdhëniet me botën islame jashtë Jugosllavisë – kjo për të mos cenuar linjat e kuqe ideologjike.

Rëndësia për komunitetin mysliman

Pavarësisht kufizimeve, “Edukata Islame” përmbushi një rol të pazëvendësueshëm për myslimanët e Kosovës:

- Ajo ofronte një ndjenjë vazhdimësie të traditës fetare në një mjedis gjithnjë më laik dhe ideologjikisht homogjen;
- Ndihmonte në edukimin fetar të brezave të rinj, të cilët ndryshe nuk kishin qasje në literaturë islame të botuar;
- Përdorej nga imamët, mësuesit fetarë dhe intelektualët si burim referimi për predikimet e tyre dhe ligjëratat nëpër xhami;
- Shërbente si një platformë e brendshme debati mbi sfidat e jetës myslimane në një shoqëri socialiste.²¹

Në këtë mënyrë, revista u shndërrua në një formë të butë të rezistencës kulturore, duke ofruar alternativë ndaj zbratësishë shpirtërore që regjimi përpiqej të impononte.

20 Edukata Islame, *Edukata Islame: Revistë shkencore, kulturore islame tremujore*, 10.

21 Edukata Islame, *Edukata Islame: Revistë shkencore, kulturore islame tremujore*, 11.

Gjendja në Shqipëri: ndalimi i plotë i botimeve fetare dhe kujtesa e “Zanit të Naltë”

Ndryshe nga Kosova dhe pjesët e tjera të Jugosllavisë, ku feja u tolerua brenda kornizave të ngushta ideologjike, Shqipëria u veçua në Europën Lindore për radikalizmin ekstrem të qasjes ndaj fesë. Kjo solli jo vetëm kontroll të rreptë mbi institucionet fetare, por një ndalim absolut të tyre pas vitit 1967, përfshirë edhe çdo lloj botimi me përmbajtje fetare.²²

Konteksti politik dhe fushata kundër fesë

Pas çlirimit të vendit nga Gjermanët në vitin 1944, Partia Komuniste e Shqipërisë (më vonë Partia e Punës) ndërmori hapa të shpejtë për të konsoliduar kontrollin mbi çdo aspekt të jetës publike, përfshirë institucionet fetare. Në vitet 1950–1960, shteti ndërhyri në reformat e brendshme të komuniteteve fetare, duke i kufizuar kompetencat dhe duke i shndërruar ato në instrumente propagandistike.²³ Ky ishte fillimi i qeverisë komuniste dhe staliniste të Enver Hoxhës për të ndikuar dhe penguar veprimtaritë fetare dhe botimet me karakter fetar, gjë që më vonë i ndaloi ato tërësisht.

Në kulmin e këtij procesi, në vitin 1967, Enver Hoxha shpalli se Shqipëria ishte bërë “shteti i parë ateist në botë”.²⁴ Si pasojë e kësaj:

- U mbyllën të gjitha xhamitë, kishat dhe teqetë;
- U ndaluan të gjitha ritualet dhe festat fetare;
- U ndalua mbajtja e emrave fetarë, simboleve dhe literaturës fetare;
- Botimet me përmbajtje religjioze u zhdukën krejtësisht nga qarkullimi.²⁵

Ky vendim nuk ishte thjesht një ndalim i aktiviteteve fetare, por një përpjekje e vetëdijshme për të fshirë çdo kujtim institucional të fesë nga kujtesa kolektive. Kështu u shënua lufta e kujtesës kolektive të së kaluarës islame, ndalimit të jetesës në mënyrë islame dhe mendimit dhe botimit të mendimeve islame. Kështu ai këto i pa si opium për masën.

22 Sabrina Ramet, *Nihil obstat: Religion, politics, and social change in East-Central Europe and Russia* (Duke University Press, 1998), 336.

23 Ramet, *Nihil obstat*, 337.

24 Norris, H. T, *Islam in the Balkans: Religion and society between Europe and the Arab world* (Carolina: University of South Carolina Press, 1993), 160.

25 Norris, H. T, *Islam in the Balkans*, 161.

Zani i Naltë: Pararendës i mendimit islam shqiptar

Para instalimit të plotë të regjimit komunist, revista “Zani i Naltë” (1923–1939), organ i Komunitetit Musliman të Shqipërisë, përbënte një nga përfaqësimet më të shquara të mendimit islam në gjuhën shqipe. Kjo revistë trajtoi çështje të besimit, moralit, edukimit dhe filozofisë islame me një gjuhë të kultivuar dhe me synime edukative e shpirtërore. “Zani i Naltë” kishte për qëllim të ndërtonte një identitet mysliman shqiptar, në përputhje me realitetin e kohës dhe të përkt-hente vlerat universale të Islamit në kuadrin kombëtar shqiptar. Kjo përpjekje ndërpritej brutalisht nga regjimi komunist, i cili pas vitit 1945 e konsideroi të panevojshme dhe të dëmshme ekzistencën e çdo platforme të tillë.²⁶ Përkundër që Revistës Zani Naltë iu ndalua botimi, revista të tjera filluan të shfaqen në Shqipëri, si Kultura Islame (1939-1945) dhe Revista Njeriut (1942-1944). Revista Kultura Islame ishte një revistë shqiptare me karakter fetar, letrar dhe kulturor. Ndërsa Revista Njeriu ishte një revistë me karakter fetar me orientim shpirtëror. Organ i saj ishte Drita Hyjnore.²⁷

Pasojat e ndalimit të botimeve islame në Shqipëri

Ndalimi i çdo aktiviteti fetar, përfshirë botimet, kishte pasoja të rënda për komunitetin mysliman shqiptar:

- U shkëput zinxhiri institucional i dijes fetare, duke ndërprerë çdo traditë të botimit të literaturës islame;
- Brezat e rinj u rritën pa asnjë kontakt me tekstet fetare, përveç atyre që mund të qarkullonin ilegalisht ose të ruheshin në mënyrë private;
- Elita intelektuale fetare u persekutua, u burgos ose u detyrua të heshtë;
- Kujtesa kulturore fetare u shtyp përmes dhunës dhe censurës totale.²⁸

Në kontrast me Kosovën, ku revista si “Edukata Islame” mund të ekzistonin brenda një lirie të kontrolluar, në Shqipëri, çdo përpjekje për të artikuluar mendimin islam u ndalua për gati tri dekada, deri në rënien e regjimit në vitin 1990.

26 Resul Rexhepi, *Zani i Naltë: Një pasqyrë e mendimit islam në Shqipëri*. Marrë nga <https://bislame.net/znrrexhepi/>

27 Ramiz Zekaj, Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët gjatë shekullit XX. Marrë nga: <https://www.iiu.edu.my/deed/quran/albanian/kultura.html>

28 Norris, H. T., *Islam in the Balkans*, 163.

Qasje të kundërta ndaj fesë: Jugosllavia dhe Shqipëria

Trajtimi i fesë në dy shtetet socialiste të Ballkanit – Jugosllavisë dhe Shqipërisë – përfaqëson dy modele të ndryshme të politikave shtetërore ndaj religjionit. Këto qasje të kundërta patën ndikim të drejtpërdrejtë edhe në fushën e botimeve islame, duke përcaktuar në mënyrë rrënjësore fatin e mendimit islam gjatë periudhës së komunizmit.

Jugosllavia: Lejimi i kontrolluar i fesë

Pas përçarjes me Bashkimin Sovjetik në vitin 1948, Jugosllavia nën udhëheqjen e Josip Broz Titos ndërtoi një model të veçantë të socializmit vetëqeverisës. Në këtë kontekst:

- Feja nuk u ndalua, por u institucionalizua dhe u kontrollua përmes bashkësive fetare zyrtare;
- U lejua një liri e kufizuar për praktikën fetare, përfshirë organizimin e haxhit, edukimin nëpër medrese dhe botimin e revistave fetare si “Edukata Islame” apo “Glasnik”;
- Feja u trajtua si një “çështje private”, që nuk duhej të cenonte ideologjinë shtetërore, por mund të ushtrohej në mënyrë të disiplinuar.²⁹

Ky model lejoi një hapësirë të vogël për shprehjen fetare publike, ku mendimi islam, megjithëse i filtruar dhe i vetëcensuruar, mund të artikulohej dhe të përçohej te besimtarët.

Shqipëria: Ateizmi shtetëror dhe zhdukja e fesë

Në kontrast të plotë, Shqipëria zgjodhi rrugën më radikale të represionit fetar:

- Pas vitit 1967, feja u ndalua me kushtetutë, ndërsa çdo formë botimi fetar u zhduk;
- U asgjësua infrastruktura institucionale e bashkësive fetare;
- Shteti u përpoq të krijojë një identitet të ri ateist dhe materialist, duke e konsideruar fenë si “opium për popullin” dhe një pengesë për modernizimin socialist.³⁰

Kjo solli një ndrydhje të plotë të mendimit islam, duke e detyruar komunitetin mysliman të ekzistojë vetëm në kujtesën personale dhe në praktikën e fshehtë.

29 Gawrych, *Tolerating Islam in a Socialist State*, 462–463.

30 Norris, H. T., *Islam in the Balkans*, 161.

Krahasimi i Qasjes ndaj Fesë Islame në Kosovë dhe Shqipëri (1945–1990)³¹

Elementi	Jugosllavia (Kosova)	Shqipëria
Statusi i fesë	Legal, i kontrolluar	I ndaluar me ligj
Botime fetare	Të lejueshme në formë të filtruar	Të ndaluara plotësisht
Shembuj revistash	Edukata Islame, Glasnik	Asnjë pas vitit 1945, ndalim total
Qasje ndaj mendimit islam	Adaptim dhe vetëcensurë	Asgjësim i plotë institucional
Efekti në komunitet	Ruajtje e pjesërishme e trashëgimisë fetare	Shkëputje e plotë ndërbrezore

Ky krahasim tregon se ndonëse të dy regjimet ishin komunistë, mënyrat e trajtimit të fesë dhe pasojat për zhvillimin e mendimit islam ishin thelbësisht të ndryshme. Jugosllavia zgjodhi një rrugë tolerimi të mbikëqyrur, ndërsa Shqipëria ndërmoi një politikë të zhdukjes ideologjike të religjionit.

Rëndësia e revistave islame si ruajtëse të kujtesës dhe identitetit në kontekstin socialist

Në një realitet ku feja përballej me censurë, persekutim dhe shpërbërje institucionale, revistat islame luajtën një rol tepër të rëndësishëm jo vetëm si organe informimi, por edhe si instrumente të ruajtjes së identitetit fetar dhe kulturor të myslimanëve. Kjo vlen veçanërisht për hapësirat e Jugosllavisë, ku ekzistonte një mundësi minimale për botim fetar, përkundër zhdukjes së plotë në Shqipëri.

Revistat si bartëse të dijes fetare

Revistat islame, të tilla si Edukata Islame, nuk përçonin vetëm përmbajtje devocionale, por ato përkthenin dhe përshtatnin tekste teologjike klasike në gjuhën shqipe, duke e bërë dijen më të qasshme për publikun. Po ashtu botonin artikuj mbi historinë islame, figura të rëndësishme të dijes, morali islam dhe çështje bashkëkohore në këndvështrimin islam.³² Në këtë mënyrë, këto revista përbënin arkiva të dijes islame në rrethana represive dhe ndihmuan në mbajtjen gjallë të një linje mendimi që përndryshe do të kishte humbur.

31 Norris, H. T, *Islam in the Balkans*, 165.

32 Rexhepi, Zani i Naltë, <https://bislame.net/znrrexhepi/>

Ruajtja e kujtesës kolektive dhe e traditës

Në kontekstin e kontrollit ideologjik, kujtesa fetare kolektive rrezikonte të shkëputej, veçanërisht tek brezat e rinj. Revistat islame kontribuan në: Rikujtimin e figurave historike myslimane shqiptare, si Hafiz Ali Kraja, Hoxhë Kadri Prishtina, Hafiz Ibrahim Dalliu; rikthimin në vëmendje të trashëgimisë shpirtërore, përmes përshkrimit të ritualeve, predikimeve, dhe përkthimeve të ajeteve dhe haditheve. Po ashtu ato krijuan një memorie institucionale, duke dokumentuar aktivitetet e Medresesë, Myftinive dhe konferencave fetare që zhvilloheshin.³³ Përmes këtyre funksioneve, revistat nuk ishin thjesht fletushka edukative, por mjet i rezistencës kulturore, që sfidonte harresën dhe asimilimin e detyruar.

Formimi i një identiteti rezistent

Në kushtet e një shtypjeje të ideologjizuar, ruajtja e një identiteti fetar kolektiv përmes mjeteve të lejuara ishte një akt që kishte rëndësi përtej shpirtërores. Ndër to Revista Edukata Islame përbënte një pikë referimi për myslimanët në Kosovë, sidomos për rininë që kërkonte kuptim në besim. Në anën tjetër përmes revistave u formua një elitë intelektuale e heshtur, që më pas, pas viteve '90, do të luante rol aktiv në riorganizimin e jetës fetare në liri.

Botimet e kohës janë sot dokumente të çmuara historike, që dëshmojnë për vazhdimësinë e mendimit islam edhe në kohë shtypjeje.³⁴ Në këtë mënyrë, revistat islame në periudhën socialiste, megjithëse të kufizuara në liri dhe ndikim, u shndërruan në mekanizma të qëndrueshëm të identitetit kolektiv dhe mbijetimit të trashëgimisë shpirtërore.

Përfundim

Ky studim shqyrtoi rolin dhe sfidat e revistave islame në kontekstin represiv të regjimeve socialiste në Ballkan, me fokus në Kosovë dhe Shqipëri gjatë periudhës 1945–1990. Në përfundim të këtij analizimi, dalin në pah disa konkluzione të rëndësishme që ndriçojnë marrëdhënien ndërmjet mendimit islam dhe pushtetit shtetëror ateist në këtë periudhë historike.

1. Dy realitete të ndryshme politike dhe fetare

Kosova dhe Shqipëria përfaqësuan dy modele diametralisht të kundërta në raport me fenë:

³³ Rexhepi, *Zani i Naltë*, <https://bislame.net/znrrexhepi/>

³⁴ Edukata Islame, *Edukata Islame: Revistë shkencore, kulturore islame tremujore*, 13.

- Në Kosovë (dhe më gjerë në Jugosllavi), ekzistoi një hapësirë e kufizuar për veprimtarinë fetare, e cila mundësoi mbijetesën e botimeve islame si “Edukata Islame”. Kjo lehtësoi ruajtjen e një vazhdimësie të mendimit fetar, sado të filtruar.
- Në Shqipëri, ndërkaq, u zbatua një model radikal i shtypjes, ku pas vitit 1967 feja u zhduk nga jeta publike, ndërsa çdo shprehje e mendimit islam u ndalua. Si rezultat, nuk kishte asnjë formë botimi islam për dekada me radhë.

2. Revistat si forma të rezistencës kulturore dhe kujtesës fetare

Revistat islame në Kosovë, sidomos Edukata Islame, nuk ishin vetëm produkte të lejuara nga shteti, por:

- Platforma për mbrojtjen e trashëgimisë islame;
- Mjete për ruajtjen e dijes fetare dhe përkthimin e saj në rrethana të reja ideologjike;
- Forma të qëndresës intelektuale në një mjedis ideologjikisht armiqësor ndaj fesë.

Ato ndihmuan në ruajtjen e vazhdimësisë së një identiteti islam shqiptar, duke u bërë ura lidhëse mes të kaluarës dhe të ardhmes.

3. Humbja dhe ringjallja në Shqipëri

Në Shqipëri, mungesa e plotë e botimeve islame çoi në një shkaputje të thellë breznore, një boshllëk kulturor dhe shpirtëror që vazhdoi deri në fillim të viteve 1990. Megjithatë, kujtimi i veprave të tilla si Zani i Naltë mbeti i gjallë në rrethet e caktuara dhe shërbeu si bazë për ringjalljen e mendimit islam pas rënies së komunizmit.

4. Rëndësia e studimit në kontekst bashkëkohor

Në kohën e sotme, ku feja është rikthyer si aktor i rëndësishëm në jetën publike dhe identitare, hulumtimi i periudhave të shtypjes si kjo është thelbësor për:

- Kuptimin e formimit të elitave fetare;
- Rishikimin e historisë së fesë nën komunizëm;
- Vlerësimin e rolit të mediave fetare në shoqëri.

Në këto rrethana revistat islame në periudhën komuniste nuk ishin vetëm mjet informimi, por akt mbijetese dhe rezistence. Në Kosovë, ato dëshmuan për fuqinë e besimit përballë kufizimeve. Në Shqipëri, mungesa e tyre është tregues i pasojave të zhdukjes së dhunshme të religjionit. Ky studim shtron nevojën

për më shumë hulumtime të thelluara mbi këtë tematikë dhe nxit një rivlerësim historik të rolit që media islame ka luajtur në ruajtjen e identitetit kulturor dhe fetar shqiptar.

LITERATURA

- Daiber, Hans. *Islamska misao u dijalogu kultura: Inoviranje i posredovanje između antike i srednjeg vijeka*. Sarajevo: Kult-B, 2007.
- Dhima, Aleksander. *Modeli i propagandës; qasje antropologjike në realitetin mediatik*. Tiranë: Polisi, 2011.
- Edukata Islame, *Edukata Islame: Revistë shkencore, kulturore islame tremujore*. Prishtinë, Bashkësia Islame e Kosovës.
- Fevziu, Blendi. *Enver Hoxha*. Tiranë: Uett Press, 2011
- Gawrych, George. *Tolerating Islam in a Socialist State: Yugoslavia and the Yugoslav Muslims. East European Quarterly*. 1983.
- H. T, Norris. *Islam in the Balkans: Religion and society between Europe and the Arab world*. Carolina: University of South Carolina Press, 1993
- Huković, Muhammed. *Zaboravljena baština*. Zagreb, 1992.
- Kajkuš, Hanidef. *Bosna Hersek'te Tefsir Çalışmaları ve Hüseyin Cozo Efendi Örneği*. Bursa: Bursa Uludag Üniversitesi, 2012, 54.
- Qazimi, Azem. *Komunitetet fetare në Shqipërinë komuniste, (dokumenta)*. Tiranë, 2014.
- Qazimi, Azem. *Procesi i asgjesimit të fesë në komunizëm*. Tiranë, 2012.
- Ramet, Sabrina. *Nihil obstat: Religion, politics, and social change in East-Central Europe and Russia*. Duke University Press, 1998.
- Rexhepi, Resul. *Zani i Naltë: Një pasqyrë e mendimit islam në Shqipëri*. Marrë nga <https://bislame.net/znrrexhepi/>
- Vickers, Miranda. *Midis Serbëve dhe Shqiptarëve, një histori e Kosovës*. Tiranë: Dituria, 2004.
- Zekaj, Ramiz. Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët gjatë shekullit XX. Marrë nga: <https://www.iium.edu.my/deed/quran/albanian/kultura.html>